



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"**  
**BORDI I ADMINISTRIMIT**

Nr. 620/5 prot.

Elbasan, me 06.03.2021

**VENDIM**

Nr 13 datë 06.03.2021

**Për**

**trajtim me bursë financiare dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit të studentëve në  
Ciklin e parë të studimeve, për program të parë studimi, për vitin akademik 2020-2021**

Në mbështetje të nenit 47 dhe 49 të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 903, datë 21.12.2016 "Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë", e ndryshuar, VKM Nr. 269, datë 29.03.2017 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit," e ndryshuar, lidhur me procesin e shqyrtimit miratimit të kërkesave online për përfitim burse financiare dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2020-2021, VBA Nr. 48, datë 20.11.2020 "Për procedurën e shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për përfitim burse financiare dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit, për vitin akademik 2020-2021", Relacionit të Administratorit "Për trajtim me bursë financiare dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit të studentëve në Ciklin e parë të studimeve, për program të parë studimi, për vitin akademik 2020-2021", Bordi i Administrimit në mbledhjen Tij të datës 06.03.2021,

**VENDOSI:**

- 1- Të përfitojnë bursë financiare 31 studentë me kriterë të tjera, mbas konfirmimit të statusit të tyre dhe brenda kohëzgjatjes normale të periudhës së studimit, sipas listës bashkëlidhur
- 2- Të përfitojnë përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit 39 studentë me kriterë të tjera, mbas konfirmimit të statusit të tyre, sipas listës bashkëlidhur.
- 3- Ngarkohet Administratori i Universitetit me zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I BORDIT**  
**ARDIAN DËRMISHI**

